



Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 4 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2021, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2021

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2021, si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Janar	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2021, 2. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2021, 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2021, 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane për vitin 2021, 5. Marrja e vendimit për Pëlqimin Mjedisorë për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisorë të PZHK-së, 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, 7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Deçanit , 8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Integritetit,	
-------	--	--

	9. Shqyrtimi i Raportit të Përformancës për vitin 2019, 10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit kundër korrupsionit, 11. Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën tonë.	
Shkurt	1.Orientimi I të hyrave vetanake të bartura nga viti 2020 në vitin 2021.	
Mars	1.Shqyrtimi I raportit analitik financiar për vitin 2020.	
Prill	1.Shqyrtimi I raportit financiar për periudhën Janar- 31 Mars 2021.	
Maj	1. Trajtim I rregulloreve komunale .	
Qershor	1. Shqyrtimi I draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024, 2. Shqyrtimi dhe aprovimi I Rishikimit të buxhetit për vitin 2021, 3. Mbledhja e I-rë Publike për vitin 2021.	Diskutim publik me qytetar Për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.
Korrik	1.Raporti gjashtëmuor I Kryetarit të Komunës, 2.Shqyrtimi I raportit gjashtëmuor financiar, 3.Marrja e Vendimit për pushim vjetor të anëtarëve të Kuvendit.	
Gusht	Pushim	
Shtator	1. Shqyrtimi dhe miratimi I Buxhetit për vitin 2022. 2. Shqyrtimi dhe miratimi I Rregullores mbi Tatimin në pronë për vitin 2022.	

Tetor	1.Shqyrtimi I Raportit nëntë mujor financiar,	
Nëntor	1. Shqyrtimi I raportit të Auditorit të Jashtëm.	
Dhjetor	1. Shqyrtimi I Raportit vjetorë të Kryetarit të Komunës. 2. Mbledhja e II-të Publike për vitin 2021.	

Neni 2.

Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura nga neni 1. i këtij vendimi gjatë vitit 2021 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-2

Deçan,dt.29.01.2021

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

